



Nr. 5026/1 Prot

Dt. 11.10.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 627/1 Prot.

Shkodër, më 07.10.2022

Lënda: Plotësim, saktësim mbi Vendimin nr. 56, datë 23.09.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut" u shqyrtua **VKB Vau Dejës nr. 56, datë 23.09.2022** "Për dhënie pëlqimi në parim, për dhënie me qera me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 37.84 ha, pjesë e pasurisë nr. 425, ZK 2993 dhe ZK 3389, të llojit Kullotë, me afat deri në 10 vjet, në fshatin Plezhe-Shkjezë, NJAD Bushat me fushë përdorimi ndërtim park fotovoltai (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse)".

Referuar Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut" Kreu II, neni 4, shkronja b, parashikon që aktet e depozituara duhet detyrimisht të shoqërohen sipas pikës "v" nga çertifikata e pronësisë ose në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK- të plotësohet

Të saktësohen ngastrat pasi me VKB është miratuar vetëm pasuria nr.425, ndërsa në relacion keni cituar pasuritë nr. 425/3 dhe 425/6- të saktësohet

Të sqarohet proceduralisht situata pasi referuar ligjit Nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" i përditësuar neni 17 shprehet: *Dhënia në përdorim e sipërfaqes së kullotave dhe livadheve, në radhë të parë, lejohet për ndërtime të përkohshme, si depo e qendra të staneve, qendra të përpunimit të bulmetit, për mullinj, për shtëpi të përkohshme verimi për blegtorët, gjithnjë në përputhje me funksionin themelor të saj si kullotë.*

Sipërfaqe të caktuara dhe toka të fondit kullosor, pronë shtetërore, mund të jepen në përdorim, për të zhvilluar në to veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike, vetëm kur:

- veprimtaria është parashikuar në planin e mbarështimit të kullotës apo livadhit ose kur nuk bie në kundërshtim me synimet e kërkesat e këtij plani;
- ushtrimi i veprimtarisë nuk e dëmton mjedisin rrethues dhe nuk ka pasoja të vazhdueshme negative mbi të;
- subjekti realizon, në vijimësi dhe përfundimisht, rehabilitimin e sipërfaqes së marrë në

përdorim, në përputhje me planin e rehabilitimit, të hartuar prej tij e të miratuar nga struktura përgjegjëse përkatëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

Për sa trajtuar, ju rekomandojmë të bëni plotësimet e domosdoshme duke pasur qëllim kryesor energjinë e rinovueshme sipas ligjit Nr.43/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme¹" neni 4, 5.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI



¹ Prioritet, objektiv i Qeverisë Shqiptare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr 56 Datë 23.09 2022

Dhënie pëlqimi në parim, për dhënien me qira me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 37.48 Ha, pjesë të pasurisë nr 425, Zk nr 2993 dhe 3389, të llojit “Kullotë”, me afat deri 10 vjet me të drejtë rinovimi, në fshatin Plezhë-Shkjezë, fusha e përdorimit “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj”).

Bazuar nënenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, neni 27 pika 5, të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr.8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. Në VKM nr. 246 dt 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, datë 28.08.2008 të Këshillit të ministrave, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike të shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, i ndryshuar, Udhëzimin nr 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, VKM nr 559, dt 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, në Vendimin nr 34, datë 26.05.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, “Për rishikimin e VKB nr 10 datë 25.02.2022 “Për miratimin në parim të listës së pasurive të llojit Kullotë, të gatshme për dhënie në përdorim”, shkresën nr 368/1 prot, datë 08.06.2022, të Prefektit të Qarkut Shkoder, si dhe pas shqyrtimit të Projekt Vendimit Nr 4, dt 18.08.2022, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritetit, Sektori i Aseteve, ku propozohet dhënia e pëlqimit në parim për dhënien me qira të pasurisë nr 425, Zk nr 2993 dhe 3389, e llojit “Kullotë, “për ndërtim park fotovoltaike (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj), pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI :

1. Miratimin në parim të dhënies me qirame anë të konkurimit me afat 10 vjeçar, të sipërfaqes totale prej 37.48 Ha, të llojit Kullotë, përkatësisht sipërfaqet prej 12.8 Ha dhe 10.5, Zk nr 3389, dhe sipërfaqen prej 14.18 Ha, Zk nr 2993, pjesë të pasurisë nr 425, (sipas Plan rilevimeve bashkelidhur) fshati Plezhë-Shkjezë, Bashkia Vau Dejës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integritit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes Publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.)

KRYETAR
Mark Bisha

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija

Miratuar me 23 vota

Vota pro 23

Vota kundër -

Vota abstenim -

Zbardhur me datë 28.09.2022

